

NJOFTIM

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, bazuar në Urdhërin Nr. 75, datë 24.09.2021 të Rektorit, *shpall* njoftimin për konkurim të hapur, për vendin e lirë të punës në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë:

1 (një) Personel akademik me kohë të plotë në grup lëndët e Inxhinierisë Elektrike, për vitin akademik 2021-2022, pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore

Përshkrimi i vendit të punës

- Pedagog me angazhim me kohë të plotë
- Mësimdhënie në grup lëndët e Inxhinierisë Elektrike
- Mbështetje për nevojat e Departamentit dhe Fakultetit.

Kritere të përgjithshme që duhet të plotësoj/në kandidati/ët

- Të jetë shtetas/e shqiptar/e
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkuron;
- Të ketë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit etiko-profesional me kolegët, studentët dhe eprorët;
- Të jetë i aftë të garantoj standartin e cilësisë dhe efikasitetin në mësimdhënie.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës për kryerjen e një vepre penale si dhe të mos jetë person nën hetim;
- Kandidati nuk duhet të ketë patur background negativ në eksperiencat e mëparshme në punë;
- Të mos jetë marrë ndaj tij masë disiplinore “largim nga puna” si dhe të mos jetë në proces gjyqësor me Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë;
- Të mos ketë vepruar ose propaganduar në drejtim të prishjes së imazhit të universitetit dhe autoriteteve drejtuese të UV-së, në median vizive dhe/apo të shkruar, rrjetet sociale etj.
- Të ketë eksperiencë pune.

Kritere të veçanta

1. Të zotëroj të paktën një nga titujt e studimit: Diplomë Master i Shkencave ose Ekuivalent i saj në fushën e **Inxhinierisë Elektrike, Mekatronike ose Elektronikë** të fituar brenda ose jashtë vendit; Diplomë Master i Nivelit të Dytë ose Ekuivalent i saj në fushën e **Inxhinierisë Elektrike** ose ekuivalente me to, të fituar brenda ose jashtë vendit; ose të ketë përfunduar formimin teorik të Shkollës së Doktoratës (60 kredite) në fushën e **Inxhinierisë Elektrike**.

Kandidatët me diploma të fituara jashtë vendit duhet të jenë të pajisur me dëshminë e njohjes dhe ekuivalentimit nga MASR, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Të këtë mesataren Universitare në **(Bsc+Msc) mbi 8 (tetë)**, ose mesataren e **DIND mbi 8 (tetë)**, si dhe ato të formimit teorik të shkollës së doktoratës mbi **8 (tetë)**.
3. Preferohen kandidatët me tituj akademik Profesor dhe Profesor i Asociuar në fushat e kërkuara.
4. Preferohen kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet e doktoratës (në fushat e kërkuara), ose janë në përfundim të studimeve të doktoratës (në fushat e kërkuara).
5. Preferohen kandidatët që kanë fituar gradën shkencore PhD në Universitetet perëndimore apo Universitete të huaja të njohura për nivelin e tyre (në fushën e kërkuar).
6. Preferohen kandidatët me aktivitet botues dhe kërkimor – shkencor
7. Preferohen kandidatët me eksperiencë në koordinimin e projekteve kërkimore dhe te zhvillimit.
8. Preferohen që kandidatët të njohin një prej 5 (pesë) gjuhëve të Bashkimit Europian: *Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht*, të certifikuar sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht (**niveli B1**), ose me dëshmi të dokumentuar nga Universiteti i Tiranës (**të paktën nota 8 (tetë)**). Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
9. Preferohen që kandidatët të kenë eksperiencë punësimi si personel shfrytëzues ose mësimdhënie në fushat përkatëse.

Vlerësimi bëhet sipas pikëve të mëposhtme:

Shkollimi

- | | |
|--|---------------------|
| 1. Për çdo 1/10 mbi notën mesatare 8(tetë) | vlerësimi me 1 pikë |
| 2. Studime të thelluara pasuniversitare, SHPU, Master i nivelit të Dytë ose ekuivalent i saj | 10 pikë |
| 3. Doktoraturë në vazhdim në fushat e kërkuara | 30 pikë |

Grada Shkencore/Titulli Akademik

- | | |
|--|--|
| 1. Doktor i shkencave në fushat e kërkuara | 50 pikë |
| 2. PhD në Universitetet Perëndimore në fushat e kërkuara | 70 pikë |
| 3. Profesor i Asociuar në fushat e kërkuara | 70 pikë |
| 4. Profesor Doktor në fushat e kërkuara | 100 pikë |
| 5. Doktor i shkencave në fusha të përafërta me fushat e kërkuara | (5-10 pikë, sipas përafërsisë me fushën e kërkuar, komisioni i |

vlerësimin gjykon lidhur me përfaqësimin me fushat e kërkuara)

Eksperienca në IAL

- Eksperienca në mësimdhënie në IAL publike, me kohë të plotë 1 pikë për çdo vit pune, por jo më shumë se 5 pikë në total, me kohë të pjeshme 0.5 pikë për çdo vit pune, por jo më shumë se 2 pikë në total.

Eksperienca e punës në profesion

- Eksperienca në profesion si personel shfrytëzues në fushat përkatëse, 1 pikë për çdo vit pune, por jo më shumë se 10 pikë në total.

Njohja e gjuhës së huaj

- Për çdo gjuhë të huaj, dhe të certifikuar sipas testeve të njohura ndërkombëtarisht (nota të paktën 8 ose niveli B1) 2 pikë

Aktiviteti kërkimor shkencor dhe i botimit

- | | |
|---|--|
| 1. Botime në revista shkencore ndërkombëtare | 2 pikë për çdo artikull |
| 2. Botime në revista shkencore kombëtare | 1 pikë për çdo artikull |
| 3. Pjesëmarrje në hartimin dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare të kërkim zhvillimit | 2 pikë për çdo projekt të koordinuar apo zbatuar |

Kandidatët të cilët dorëzojnë dokumentacion të pa noterizuar, ose kanë mungesë në dokumentacion nuk do të merren në shqyrtim nga komisioni.

Dokumentacioni i kërkuar

- Formulari i aplikimit i plotësuar nga aplikanti. Gjetet në adresën www.univlora.edu.al
- Jetëshkrim/ CV;
- Diploma/t universitare (kopje e noterizuar);
- Lista e notave e studimeve universitare (origjinal);
- Tituj akademik ose grada shkencore (kopje e noterizuar);
- Dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve, arsimim shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrim (kopje të noterizuara);
- Artikuj të botuar, projekte shkencore, etj;
- Dëshmi të pjesëmarrjes në konferenca, seminare, *workshop-e*, etj (kopje të noterizuara);
- Libreza e punës (origjinale ose kopje të noterizuar)
- Raport mjekësor për aftësinë në punë, lëshuar 3 muajt e fundit (origjinal);

- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dokument origjinal i lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor);
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;

Shënim:

Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në nenin 92 të Ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

Mënyra e aplikimit

Dokumentat duhet të dorëzohen **vetëm nëpërmjet shërbimit postar** në adresën:



- **Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Lagjja. "Pavarësia", Rr. "Kosova" 9400 Vlorë, Shqipëri.**
- **Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.**
- **Personel akademik me kohë të plotë për grup lëndët e Inxhinierisë Elektrike pranë Departamentit të Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare**

Afati për aplikim

- ✓ Afati për të aplikuar është 2 dy (javë) kalendarike. Ky afat fillon nga data e nesërme e publikimit të njoftimit në web-site zyrtar të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë: www.univlora.edu.al. (njoftimi u publikua në datën 28.09.2021 dhe afati përfundon në datën 13.10.2021.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar në shërbimin postar pas datës 13.10.2021, do t'i kthehet aplikantit pa veprime.

Procedura e punësimit të personelit akademik

- ✓ Punësimi i personelit akademik në UV bëhet me konkurs.
- ✓ Konkurrimi do të kryhet në dy faza: vlerësimi i dosjes dhe intervista e drejtëpërdrejtë e kandidatit.
- ✓ Dokumentacioni i dorëzuar nga aplikanti në kundërshtim me kërkesat e shpallura, nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni *ad hoc*. Vlerësimi do të kryhet vetëm mbi bazën e dokumentacionit të konsideruar të vlefshëm.
- ✓ Komisioni *ad hoc* njofton kandidatët për rezultatet e vlerësimit të fazës së parë.
- ✓ Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni *ad hoc*, paraqiten te Rektori brenda 5 (pesë) ditëve.
- ✓ Kandidatit i lind e drejta e ankimit nga e nesërmja e njoftimit të vendimit për fazën e parë të vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar. Në këtë rast, Rektori

urdhëron komisionin *ad-hoc* për pezullimin e procedurës së konkurimit deri në përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, Rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*. Vendimi i rektorit i njoftohet komisionit *ad-hoc* i cili në vijim cakton datën dhe njofton kandidatët fitues për zhvillimin e intervistës me gojë.

- ✓ Kandidati i cili kalon fazën e parë të kualifikimit të dosjes, por nuk paraqitet në fazën e dytë të intervistës me gojë, skualifikohet nga konkurimi.
- ✓ Komisioni *ad hoc* vlerëson dhe rendit kandidatët konkurues sipas pikëzimit të vendosur në rregulloren e UV-së dhe ia përcjell Rektorit i cili vendos në mënyrë përfundimtare mbi secilën kandidaturë.
- ✓ Kundër vendimit të fazës së dytë për vlerësimin e intervistës, kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi. Në këtë rast, Rektori urdhëron shqyrtimin e ankimit. Kur vlerëson se ankimi është i pranueshëm, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të ankimit, rektori vendos me një akt të ri anulimin, shfuqizimin ose ndryshimin e vendimit të komisionit *ad-hoc*.
- ✓ Vendimi përfundimtar i Rektorit për miratimin e klasifikimit përfundimtar dhe shpalljen e fituesit, i njoftohet palëve të interesuara.
- ✓ Rektori emëron kandidatin fitues dhe nënshkruan kontratën e punës.

DREJTOR

Eloina TOZAJ